

VENDIM
Nr.10, datë 15.4.2020

PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT TË AKOMODIMIT TË PËRKOHSHËM TË PERSONAVE QË RIATDHESOHEN SI REZULTAT I GJENDJES SË SHKAKTUAR NGA COVID-19

Në mbështetje të ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, të aktit normativ nr.3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar, të vendimit nr.243, datë 24.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, dhe në vijim të marrjes së masave për përballimin e epidemisë të shkaktuar nga COVID-19, Komiteti Ndërmintoror i Emergjencave Civile, i mbledhur sot në datën 15.4.2020,

VENDOSI:

1. Propozimin për miratim Këshillit të Ministrave të mënyrës së organizimit të akomodimit të përkohshëm të personave që riatdhesohen, si rezultat i gjendjes së shkaktuar nga COVID-19, sipas projektvendimit bashkëlidhur.
2. Ngarkohen ministri i Turizmit dhe Mjedisit, ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministri i Brendshëm dhe Agjencia Kombëtare e Bregdetit për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR I KOMITETIT NDËRMINTOROR
TË EMERGJENCAVE CIVILE

KRYEMINTËR
Edi Rama

PROJEKTVENDIM PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT TË AKOMODIMIT TË PËRKOHSHËM TË PERSONAVE QË RIATDHESOHEN SI REZULTAT I GJENDJES SË SHKAKTUAR NGA COVID-19

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 41, të ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, të aktit normativ nr.3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave për mënyrën e organizimit të akomodimit të përkohshëm të personave që riatdhesohen si rezultat i shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19 në strukturat akomoduese, të miratuara rast pas rasti me vendim të Komitetit Ndërmintoror të Emergjencave Civile, sipas rregullores që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Akomodimi i përkohshëm i personave të riatdhesuar bëhet nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Brendshme.
3. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, pas evidentimit nga Shoqata Shqiptare e Turizmit (ATA) dhe Unioni Turistik Shqiptar (UTSH), përzgjedh strukturat akomoduese ku do të kryhet

akomodimi i përkohshëm i personave dhe ia përcjell për miratim Komitetit Ndërmintor të Emergjencave Civile.

4. Shpenzimet e akomodimit të përkohshëm të riadhesuarve mbulohen një pjesë nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit dhe pjesa tjetër nga personi i riadhesuar, sipas përcaktimeve të rregullores që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Vetëm për strukturat akomoduese, që kanë marrëveshje me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, do të kryhen pagesat nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit, sipas marrëveshjes tip, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

6. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale kujdeset për shëndetin e personave të riadhesuar dhe merr masa për respektimin e kushteve që duhet të ndiqen në përputhje me aktet ligjore/nënligjore në kuadër të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.

7. Ministria e Brendshme, nëpërmjet Policisë së Shtetit, merr masat e nevojshme për shoqërimin e personave të riadhesuar në strukturat akomoduese dhe siguron moslargimin e tyre nga këto struktura, sipas procedurave dhe afateve të përcaktuara në aktet ligjore/nënligjore në kuadër të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.

8. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Brendshme dhe Agjencia Kombëtare e Bregdetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama